



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
MUNICIPAL OF ASSEMBLY IN DRAGASH
SKUPSTINA OPSTINE DRAGAS



Datë: 14.06.2023
02 Nr.020-10821-1/23

PROCESVERBAL

Dëgjimi i I-rë Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026
I mbajtur më 14.06.2023, e mërkurë, duke filluar nga ora 10:00
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Njoftimi për këtë Dëgjim Publik është publikuar më 15.05.2023:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://kk.eks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/05/13/dëgjimi-i-1-rë-publik-2023.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.eks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/05/13/dëgjimi-sk-up-2023-1.pdf>

Në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=589627469933107&set=pcb.589627546599766>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=589627509933103&set=pcb.589627546599766>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Resul Fetahu – Nënkyetar
3. Fejsal Halilovic – Nënkyetar për Komunitete
4. Zeni Krasniqi – Drejtor i DKA-së
5. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
6. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
7. Liridona Misinaj – Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
8. Behar Brenoli – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
9. Bean Hadziasan – Drejtor i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit
10. Veton Halili – Shef i Kabinetit
11. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas

02 Nr. Br. 020-10821-1/23
14.06.2023
Dragash - Dragas

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 61 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 27
2. Meshkuj: 34

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini, në cilësinë e kryetarit të Komunës, i përshëndeti dhe i falënderoi për pjesëmarrje të gjithë qytetarët. Ai tha se ky debat publik për buxhetin do të vazhdojë dhe do të jetë i hapur deri në shtatorin e këtij viti, ku Asambleja Komunale do të marrë një vendim për buxhetin e vitit të ardhshëm. Korniza Afatmesme të cilën po e prezantojmë është një dokument i rëndësishëm së veçantë, i cili miratohet në parim për çdo vit nga Asambleja Komunale dhe vihet në diskutim publik deri në miratimin e buxhetit të Komunës, për periudhën 2024-2026.

Buxheti për vitin 2024 për Komunën e Dragashit, në raport me vitin e kaluar, është për 10.22% më i madh, ndërsa financimi nga Granti Qeveritar është gjithashtu 10.32% më i lartë. Në arsim është 16.65% më i lartë, mirëpo këtu është problemi se Ligji mbi pagat i cili ka hy në fuqi, edhe pse është rrit buxheti për arsim, kjo nuk është reflektuar në rritjen e investimeve kapitale në arsim, por i gjithë ky buxhet ka shkuar në mbulimin e Ligjit të pagave.

Të hyrat vetanake për vitin e ardhshëm do të jenë 464,450 euro. Buxheti për shëndetësi është i njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Buxheti për vitin e ardhshëm është 12,110,967 euro. Nga kjo:

Granti i Përgjithshëm – 6,607,712 euro

Granti i Shëndetësisë – 1,400,000 euro

Granti i Arsimit – 3,638,000 euro

Të hyrat vetanake – 464,450 euro.

Nga ky buxhet parashihen:

Për paga – 6,318,000 euro

Mallra dhe Shërbime – 1,300,000 euro

Shpenzime Komunale – 200,000 euro

Subvencione – 300,000 euro

Shpenzime Kapitale – 4,000,000 euro

Nga shuma e Shpenzimeve Kapitale prej 4 milionë euro, ne kemi paraparë që 2 milionë euro për vitin 2024 të ndahen për rrjetin e Ujësjellësit. Siç e dini, ky projekt do të kushtojë diku 4 milionë euro dhe është prioritet i yni. Ndërsa planifikojmë të ndajmë 500 mijë euro për Fabrikën e përpunimit të ujit, e cila është si pjesë përbërëse e projektit të përgjithshëm të Ujësjellësit.

Për vitin e ardhshëm planifikojmë të ndajmë 80 mijë euro për përfundimin e punimeve të Stadionit, 40 mijë euro për asfaltimin e rrugës të cilën e kemi trasue me KFOR-in Turk, 40 mijë euro për ndërtimin e trotuareve dhe ndriçimit të kësaj rruge, 20 mijë euro për përgatitjen e projekteve për vitin 2024, 40 mijë euro për ndërtimin e një parku në qytezën e Dragashit, 18 mijë euro për ujësjellësin e Kukajanit, afër 30 mijë euro për renovimin e shkollës në Brod, 150 mijë euro për ndërtimin e QMF-së në Krushevë, 23 mijë euro për kubëzimin e rrugëve në Kosavë, 20 mijë euro për nxëmjen qendrore në shkollën e fshatit Kosavë, 128 mijë euro për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Brezne, 44 mijë euro për kubëzimin e rrugëve në fshatin Shajne, rreth 5 mijë euro për asfaltimin e rrugës Brrut-Zgatar. Për asfaltimin e rrugës Kapre – Rrenc kemi paraparë 6,800 euro, për ndriçimin publik në Bellobrad 10 mijë euro. Nga mjetet të cilat kanë mbet, rreth 1 milion e 200 mijë euro, 307 mijë euro kanë mbetur mjete të lira për projekte të reja të komunitetit joshumicë, dhe 431 mijë euro mjete për projekte të reja për komunitetin shumicë, gjegjësisht komunitetin shqiptar.

Qamil Kolloni, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, përshëndet kryetarin dhe të gjithë pjesëmarrësit. Më duhet të ju raportoj për vitin 2023. Për këtë vit buxheti ndahet në:

Paga dhe mëditje – 5,224,000

Mallra dhe shërbime - 1,250,000

Shpenzime komunale – 150,000

Subvencione – 300,000

Investime Kapitale – 3,938,000

Deri më tash për vitin 2023 kemi 96 projekte të cilat janë parapa të investohen në Komunën e Dragashit. Deri në këtë moment janë të nënshkruara 34 kontrata dhe në disa lokalitete janë duke u kryer punimet ose kanë përfundue dhe në proces e sipër janë edhe 44 kontrata tjera. Vetëm 18 projekte janë ende pa hy në proces, që brenda kësaj kohe mendojmë se do t'i realizojmë.

Gjithashtu, komuna gjatë këtij viti ka bërë dy memorandume me 'Ekoregjonin'. Memorandumi i parë përfshinë blerjen e 30 kontenierëve, ku komuna participon me 10 mijë euro. Ndërsa memorandumi i dytë shumë i rëndësishëm, që i takon mbrojtjes së ambientit, është pastrimi i parqeve publike, dhe gjatë këtij pastrimi parashihet një herë në javë të bëhet edhe pastrimi i qytetit.

Kërkesat dhe propozimet qytetarëve

Xhylferije Bahtijari – Bresanë: Përshëndetje për të gjithë, në mënyrë të veçantë gratë që sot janë prezente këtu! Gratë në përgjithësi kanë edhe disa kërkesa pak më specifike, në lidhje me këtë kemi mbajtur takime me asambleistet dhe me zyrtaren për Barazi Gjimore. Unë do të shpreh një kërkesë në lidhje me fshatin Bresanë, për një sallë të tubimit e cila mungon në një fshat të madh siç është Bresana, për takime të ndryshme. Në Bresanë ka objekte të ndryshme të cilat i përkasin Komunës, vetëm nevojitet një investim ndoshta i vogël, nga i cili mund të përfitojnë edhe gjinia tjetër.

Sead Ibrahimimi – Dragash: Më gëzon fakti që në Komunë e Dragashit ndërtohet shumë. Në Dragash na duhet një stadium ose vend, park për fëmijët. Një park që është bërë është i vogël, duhet një park tjetër. Kualiteti i ujit të pijshëm është i dobët. Kërkoj që stadiumi në Dragash të ndërtohet më mirë, me infrastrukturë përcjellëse. Duhet të ndërtojmë edhe një mur mbrojtës rreth varrezave të Dragashit.

Salmira Usmeni – Dragash: Më vjen mirë që shumica e pjesëmarrësve janë gra. Kërkoj që të bëhet një vend për tubim edhe në Dragash. Na duhet edhe ndërtimi i një parku për fëmijë, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta. Propozoj vazhdimin e kubëzimit të rrugës Leshtan-Radeshë. Gratë e Dragashit duhet t'i mbështesni me Start Up biznese, t'i mbështesim ato përmes QPS-së dhe të bëhet organizimi i kurseve të ndryshme për trajnime.

Shaban Skenderi – Brrut: Ju përgëzoj për punë që po e bëni me stafin tuaj! Për neve si fshat, meqenëse kërkesat janë shumë të mëdha, buxheti është i limituar për këtë punë e cila po bëhet, mirëpo ne kemi nevojë për kubëzime dhe disa punë tjera.

Kapllan Fetahu – Kuk: Dëgjuam që edhe viti 2024 ka projekte dyvjeçare. Po shpresoj që projektet të cilat janë t'u bo, mos ta kenë fatin e fshatit Kuk, se ka qenë një projekt trevjeçar, dy projekte me një mënyrë realizohen, njëri është humbje e madhe e atyre mjeteve. Sa i përket investimeve për vitin 2024, në fshatin Kuk kanë mbet edhe 4-6 rrugë që duhet vitin e ardhshëm të kryhen. Prioritet i prioriteteve për vitin 2024 që do të jetë në fshatin Kuk është Uji. Janë bërë investime të mëdhaja, janë dhënë qindra e mijëra euro, por ujin e kemi për momentin të ndotur. Tjetër prioritet është rruga Kuk-Kosavë ose anasjelltas, është një pjesë tjetër që duhet me u çelë, jo kah Kalandert por kjo rruga tjetër.

Anesa Mehmeti – Kuk: Së bashku me asambleistet dhe zyrtaren për Barazi Gjinore, duke qenë se u takuam me gratë e fshatrave Bresanë dhe Kosavë, si dhe bisedat private që i kam bërë më gratë e fshatrave tjera, morëm opinionet dhe kërkesat e tyre lidhur me sfidat brenda atyre vendbanimeve. Ndërmjet të tjerave ato u interesuan që t'i kenë të paguara shpenzimet e udhëtimit për nxënësit e shkollës së mesme. Pagesa e kështillë do t'i ndihmonte ato familje financiarisht dhe do ta ndalte shkollimin e nxënësve nëpër shkollat e Prizrenit.

Vezir Reshiti – Bresanë: Jam kryetar i fshatit Bresanë, kam disa kërkesa. Në disa lagje të reja në Bresanë ka nevojë për kanalizim edhe kubëzime. Ju përshëndes!

Ylli Qafleshi – Bellobrad: Duke pasur parasysh se projekti i Ujësjellësit e prek edhe fshatin Bellobrad, unë i kam bërë disa kërkesa të vogla. Kërkohen ndarje të mjeteve për përfundimin e projektit të ndriçimit publik në fshatin Bellobrad, sepse është projekt dyvjeçar. Ka kërkesë për kubëzim dhe riparim të rrugëve ekzistuese, edhe ka kërkesë për një kanalizim, disa fshatarë kanë bërë kërkesën moti, po duhet me e realizue këtë vit, nëse ka mundësi.

Dreni Myrtezani: Me shumën e ndarë për vitin 2024, mendoj që të vazhdohet kubëzimi i disa rrugëve. Ky është propozim fillestar, nëse eventualisht rritet buxheti për fshatin, mendoj të kemi projekte më të mëdha edhe më konkrete, së bashku dhe në konsultim me kryesinë e fshatit do t'i sjellim propozimet tjera. Faleminderit!

Zeni Krasniqi – Buqe, drejtor i DKA-së: Megjithëse DKA ka shumë kërkesa, unë jam përcaktue për dy: Kërkojmë që të parashihen mjete për pajisjen e sallës së edukatës fizike në shkollën '28 Nëntori' në Bresanë. Kërkesa e dytë është për një projekt dyvjeçar për dy shkolla, ShFMU 'Zenuni' në Brod për renovim, si dhe në ShFMU 'Ulina' në Kosavë për instalimin e ngrohjes qendrore.

Miran Halimi – Blaç: Përshëndetje për të gjithë! Ne jemi me tri kërkesa tona: riparimi i burimit të ujit dhe ujësjellësi, për ujëmbledhësin, kubëzimin e rrugëve edhe parkun e fshatit. Faleminderit!

Sabahat Hasani – Zgatar: Po foli në cilësinë e përfaqësuesit të komunitetit të fshatit Zgatar. Kemi shumë kërkesa, po në pamundësi që me i realizue, i kisha lut organet kompetente që për vitin që do të vjen të bëjnë rrethimin e varrezave të reja.

Isa Bajrami – Shajne: Kërkesë e banorëve të fshatit Shajne është që të bëhet vazhdimi i ndriçimit publik në fshatin Shajne, si dhe pahija elastike për 100 metër rrugë, për shkak se në sezonën e dimrit po ka probleme, si dhe kubëzim në disa lagje.

Valbona Fejzi – Bresanë: Unë sot këtu përfaqësoj një grup të grave, të cilat i mësoj atje në Bresanë, në xhami. Ndër kërkesat e shumta që ato kanë, si kërkesë e parë është që në fshatin tonë të ketë një doktoreshë gjinekologe, nëse jo më shumë, të paktën një herë në javë. Si kërkesë e dytë është që në shkollën tonë të ketë një psikolog dhe si kërkesë e tretë është që të ketë kurse të ndryshme për grupmoshën e dytë, të cilat janë pa arsim të lartë, në mënyrë që të kenë mundësi më pas edhe të punojnë.

Fari Kolloni – Kosavë: Faleminderit! Kam tri kërkesa: ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e fshatit, vazhdimi i kubëzimit dhe ndërtimi i rigollave përgjatë rrugës Kosavë-Mejdan, si dhe ndërtimi i murit mbrojtës të Lumi në lagjen Besen.

Lindita Kozmaqi Piraj: Përshëndetje për të gjithë! Sot më bëhet qefi shumë, e kemi një strukturë bukur të balancuar. Deshta të flas këtu në emër të atyre grave të cilat nuk janë prezent edhe nuk janë të integruara, nuk e kanë një vend të punës. Në të dy fshatrat që ishim, të gjitha gratë kërkesë imediate e kishin mundësinë e punësimit, ngritjen e kapacitetit të tyre profesional, mirëpo punësimi mundësisht me ndonjë minifabrikë ose me ndonjë fabrikë në Opojë, për arsye se largësinë e Dragashit e shohin si problematike. Po ashtu ishte edhe transporti ndërmjet fshatrave, transporti me Dragashin, problem edhe për gratë e Bresanës, por më specifike e grave të Kosavës, të cilat e paraqiten si problem edhe transportin përbrenda fshatit. Ato e shprehën si ide që edhe Pllajnikun me e lidhë disi me mundësi transporti. Është e kohës të mendohet që në qytezën tonë ta kemi një institucion që është qëndrim ditor për pleqtë, ku pleqtë mund të dalin, të mblidhen dhe të socializohen. Po ashtu edhe banimi social. Komunitat tjera kanë filluar, ne kemi mbetur ende pa një zgjidhje të banimit social.

Brendi Berisha – Buqe: Përshëndetje për të gjithë! Këtu vij me kërkesa për fshatin Buqe. Kërkoj nga ekzekutivi që në vazhdim për vitin 2024 të bëhen kubëzime dhe kanalizim, kemi nevojë për vazhdim të projekteve aktuale.

Uzair Hamza – Kërstec: Më vjen keq që prezenca e përfaqësuesve të fshatrave të komunitetit shumicë është e dobët. Si shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, dua të them se buxheti është në

përputhje me aktet ligjore dhe normat, sa i përket shpërndarjes së përqindjes për komunitetet. U plotësua përqindja prej 41%. Një pjesë e madhe e buxhetit këtë vit është fokusuar në ndërtimin e Ujësjiellit qendror, projekt ky i cili ka qenë në plan që nga vitet e kalura. Kushtet dhe mënyrën e përdorimit të Ujësjiellit qendror duhet ta sqarojmë më tej.

Eldi Gashi – Brezne: Përshëndetje të pranishëm! Përveç kërkesave aktuale të fshatit, kanalizimi dhe ujësjielli, të cilat janë të domosdoshme, kisha pas kërkesë tjetër që kam hasur te qytetarët, ata kanë nevojë edhe për udhëtimin e nxënësve, të cilët duhet të kenë udhëtimin e paguar, sepse ata për shkak të financave po fokusohen më shumë në Prizren.

Agon Baxhaku – Bellobrad: Përshëndetje të gjithëve! Kryetar, e kemi një problematikë të madhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim është bërë pak prej se është mbyllur Handikos-i në Komunën e Dragashit. Ne si komunë duhet t'i rishikojmë disa çështje që me pas mundësi të kontraktimit të shërbimeve, të organizatave të licencuara dhe të specializuara për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Si çështje e dytë dhe si propozim për ju, kryetar, do të ishte mirë në qoftë se për çdo fëmijë që lind në Komunën e Dragashit, të kemi një mundësi prej buxhetit komunal që t'u ndahet një pako higjienike-ushqimore për këta fëmijë. Si pikë tjetër, do të ishte një mundësi e mirë në qoftë se ne, grave edhe fëmijëve, ose edhe burrave që janë në strehimore dhe nuk kanë mundësi të kthehen në familjet e tyre, të gjendet një mundësi buxhetore për mbështetjen të paktën gjashtëmujore të qirasë së tyre.

Allma Bajrami Myrtezani – mësimdhënëse: Unë e kam një kërkesë, që rrugët me qenë më të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Faleminderit!

Arijeta Qaflehi Skeraj – asambleiste: Disa kolege i cekën kërkesat që kemi marrë nga takimet me gra që kemi pasur së bashku me zyrtaren për Barazi Gjinores dhe disa asambleiste. Një ndër kërkesat nga një arsimitare e shkollës së Kosavës ka qenë që shkollat në Dragash të pajisen me kompjuterë. E para, e dyta është fëmijët që janë me autizëm, është mirë që kryetari t'i identifikojë sa fëmijë janë me autizëm dhe të paktën të ia mundësojmë pagesat që tri herë në javë i transferojnë në Prizren për ta marrë terapinë që iu duhet atyre. Kjo ishte një kërkesë e një nëne prej fshatit Kosavë.

Kryetari Bexhet Xheladini i falënderoi të gjithë ata që morën pjesë në këtë Takim publik dhe të cilët diskutuan. Ai tha se debati do të jetë i hapur deri në shtator dhe se ndërkohë mund të bini propozime. Buxheti përfundimtar nga Asambleja Komunale do të miratohet në shtator.

Me vëmendje i dëgjova të gjitha kërkesat. Shumica dërmuese janë kërkesa të arsyeshme dhe që bien në kompetencë të pushtetit lokal. **Ka edhe disa kërkesa të cilat nuk janë në kompetencën tonë,** po në bazë të analizës preliminare që e bëra, **90% të kërkesave janë të realizueshme dhe ato mund të futen në buxhetin e vitit të ardhshëm.**

Fotografi nga Takimi i I-rë Publik për KAB:







LISTA

E pjesëmarrësve në: DEGJIMI I-Ë PUBLIK (KAB 2024-2026)

Uësnika na: _____

Data/Datum: 14.06.2023

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Nga/ Iz	Nënshkrimi
1	Sejati Kurtishi	Brodosane	Sejati K.
2	NIMETE BERISHA	BUÇE	N. Berisha
3	SHQIPRIE POARIMJA	DRAGASH	Shqiprija
4	Ulimozë Bousho	Dragash	Ulimozë
5	LINDITA PIRAJ	Dragash	Lindita
6	Vaseni Selmira	Dragas	Vaseni
7	Amena Mehmeti	Zgatar	Mehmeti
8	Klysterie Bahitjari Bogjiri	Bresane	Bahitjari
9	Valbona Fejzi	Brenari	Fejzi
10	Berolise Krasniqi	Buce	Berolise
11	Desirata Aslani Krasniqe	Buce	Desirata K.
12	Allma Myrtetari	Zaplluxhe	Allma Myrtetari
13	Besiana Piraj	Flare	Besiana
14	Hasije Sejdi	Dragashit	Hasije
15	Sanela Dabijali	Prizren	Sanela
16	Ngjona Vehapi	Shajne	Vehapi
17	Nadire Selimi	Prizren	N. Selimi
18	Hanomele Thakoni	Dragash	Thakoni
19	Trueda Gasli	Prizren	Gasli
20	Veton Dafleshi	Bellohrad	Dafleshi
21	Abelina Rizu	Bellohrad	Rizu
22	Ketuna Krasniqi	Brezne	Ketuna
23	Mirza Holimi	Blac	Holimi
24	BEHAR SELMANI	KU K	Behar Selmani
25	DIBRAN RIZU	BERUT	D. Riz
26	Mbrakimi Sahal	DENEA	M. Sahal
27	BEON Hodajusan	BROD	H. Beon
28	Bilall Sejani	BOSEC	Sejani



[Handwritten signature]

29	YLLI QAFLESHI	BELLOBRAD	<i>[Signature]</i>
30	ISA Bajrami	Shajne	<i>[Signature]</i>
31	ZAHADIN AHMETI	BRESANË	<i>[Signature]</i>
32	ISA MEHMETI	BRESANË	<i>[Signature]</i>
33	Erkan Destani	Bresanë	<i>[Signature]</i>
34	VEZIR REPHITI	DRAGASH	<i>[Signature]</i>
35	FITIM SPATHU	DRAGASH	<i>[Signature]</i>
36	ARBEN SILEKOPRI	DRAGASH	<i>[Signature]</i>
37	Shaban Skender	BREUT	<i>[Signature]</i>
38	Eldi Gashi	Brezne	<i>[Signature]</i>
39	Dreni Myrtezemi	Zepituxhe	<i>[Signature]</i>
40	LIRIDONA MISINAJ	PLLAVE	<i>[Signature]</i>
41.	VETIM RAMADANI	BLAC	<i>[Signature]</i>
42	Samidin Xheladini	Brodurane	<i>[Signature]</i>
43.	MUNIR Jonuzi	Rajca	<i>[Signature]</i>
44	Kopllan Fetohu	KUR	<i>[Signature]</i>
45	Zeni Krasniqi	DKA	<i>[Signature]</i>
46.	Flajeta Gheraj	Asambleisi ^{Bane}	<i>[Signature]</i>
47.	Qenda Bajrami	Asambleiste	<i>[Signature]</i>
48	Xhemile Elhami Shala	DKRS - Brezne	<i>[Signature]</i>
49	Bayan Begaj	Bellobrad	<i>[Signature]</i>
50	Mzeur Hamza	Kosturc	<i>[Signature]</i>
51	Broni Bejta	Buce	<i>[Signature]</i>
52	Hysni Haxhani	Breut	<i>[Signature]</i>
53	Xherahin Bojoxhiu	Pllor	<i>[Signature]</i>
54	Ventura Eshti	Lejtene	<i>[Signature]</i>
55	Naemije Velija	Zepituxhe	<i>[Signature]</i>
56	Fari Kolleni	Kosare	<i>[Signature]</i>
57.	Agon Bozhaka	Bellobrad	<i>[Signature]</i>
58	Veton Halili	Zepituxhe	<i>[Signature]</i>
59	Ylber Suleaj	BLAC	<i>[Signature]</i>
60	Adem Guni	ZGARR	<i>[Signature]</i>
61	SUAD TOSUNI	RAPEN	<i>[Signature]</i>

